



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0673

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE Gani Krasniqi B.I. kundër Njoftimit e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve të MSH-se” me numër të prokurimit:206-25-4944-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Ministria e Shendetesise, më 09/09/2025, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE Gani Krasniqi B.I. me nr. 2025/0673 e datës 21/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve të MSH-se” me numër të prokurimit:206-25-4944-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Ministria e Shendetesise, **ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.**

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 27.06.2025 Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Servisimi i automjeteve të MSH-se” me numër të prokurimit: 206-25-4944-2-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 91,000.00 €.

Me 11.07.2025, OE Gani Krasniqi B.I. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Kurse me datën 11.07.2025 i është aprovuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues.

Me 21.07.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Gani Krasniqi B.I. me nr. 2025/0673 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve të MSH-se” me numër të prokurimit: 206-25-4944-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Gani Krasniqi B.I. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1.

Në njoftimin për Kontratë dhe Dokumentet Teknikë (DT), në Kapacitetin mbi mundësitë teknike dhe profesionale, respektivisht neni 9.1 dhe 9.2, kërkesa me Nr. 3 ka kërkuar që Operatori Ekonomik të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e kontratës. Për pikat:

- d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes Benz C4 Plus origjinale
- dh. Diagnoza BMW ISTA+
- e. Pajisje diagnoze origjinale për Peugeot (DIAGBOX)
- é. Pajisje diagnostikuese për WV, Škoda, Audi, Seat - ODIS (VNCI 6154 A)

Për këto pajisje, pikat d, dh dhe é, Ju si AK (Autoriteti Kontraktues) keni vendosur kritere diskriminuese, pasi për këto pika nevojitet vetëm një pajisje kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.

Kërkesa e AK-së që OE-ja duhet të posedojë pajisje të tilla si: d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes Benz C4 Plus origjinale, dh. Diagnoza BMW ISTA+, e. Pajisje diagnoze origjinale për Peugeot (DIAGBOX), dhe é. Pajisje diagnostikuese për WV, Škoda, Audi, Seat - ODIS (VNCI 6154 A), është e panevojshme dhe absurde, pasi këto shërbime mund të kryhen me vetëm një pajisje kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve. Me

një pajisje speciale mund të kryhen të gjitha shërbimet në të gjitha llojet e automjeteve, pa pasur nevojë të përcaktohet lloji i pajisjes me emër përkatës dhe me kode. Pajisja speciale mund të bëjë identifikimin e të gjitha llojeve të automjeteve.

Kërkesa Nr. 3 për pajisjet në pikat d, dh dhe é, është favorizuese për një OE të caktuar, pasi AK-ja në Njoftimin për Kontratë dhe DT ka kërkuar pajisje me emra të prodhuesve dhe specifika që i përshtaten vetëm një OE-je, si p.sh. C4 Plus origjinale, BMW ISTA+, (DIAGBOX), ODIS (VNCI 6154 A), ku për këto shërbime kërkohet vetëm një pajisje. Në këto raste, AK-ja nuk ka siguruar një proces të mirëfilltë të prokurimit.

Nga cilido këndvështrim që të analizojmë, kërkesat për këto pika janë kërkesa diskriminuese. Autoriteti Kontraktues ka përpiluar Dosjen e tenderit në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së. Po ashtu, kjo kërkesë është në kundërshtim të plotë me nenin 69 të LPP-së. Kërkesa Nr. 3 e vendosur për pajisjet në pikat d, dh dhe é është e dukshme se është përcaktuar që në fillim fituesi i këtij tenderi, për shkak se janë kërkuar pajisje të panevojshme, ku këto shërbime mund të kryhen me vetëm një pajisje.

Kërkesat Nr. 3 për pikat d, dh dhe é, nuk janë në përputhje të plotë as me Aneksin 1, Specifikacionin teknik dhe listën e çmimeve. AK-ja ka përshkruar të gjitha automjetet, tipin, vitin dhe sasinë e automjeteve. Ka kërkuar një pajisje për: d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes Benz C4 Plus origjinale, ku AK-ja posedon vetëm një automjet të tipit Mercedes 180 C 2.0 (Benzin), vit 2002, 1998 cm³. Për këtë automjet Mercedes 180 C Benzin, vit i prodhimit 2002, AK-ja ka kërkuar pajisje origjinale për diagnostifikim, automjet që nuk është i pajisur me pajisje për identifikimin e defekteve, pasi është i vitit të prodhimit 2002.

Në listën e çmimeve, AK-ja ka në posedim edhe automjetin Opel Mervano 2021, 2.3 dizel. Për këtë automjet të vitit të prodhimit 2021, të teknologjisë së fundit, AK-ja nuk ka kërkuar fare pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Opel origjinale, siç ka bërë për automjetet e tjera.

AK-ja ka kërkuar pajisje për diagnozën origjinale BMW ISTA+, ndërkohë që AK-ja posedon vetëm një automjet të tipit BMW të vitit të prodhimit 2015. Pajisja ISTA+ e kërkuar nga AK-ja është për automjetet BMW të vitit të prodhimit 2023-2025, ndërsa automjeti i AK-së është i vitit të prodhimit 2015. Këto shërbime të diagnozës mund të kryhen gjithashtu me pajisje kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.

Pajisja diagnoze origjinale për Peugeot (DIAGBOX) e kërkuar nga AK-ja në Njoftimin për Kontratë dhe DT, në specifikacionin teknik dhe listën e çmimeve, tregon se AK-ja posedon vetëm katër automjete të tipit Peugeot. Këto shërbime të diagnozës mund të kryhen gjithashtu me pajisje kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.

Pajisja diagnostikuese për WV, Škoda, Audi, Seat - ODIS (VNCI 6154 A) e kërkuar nga AK-ja në Njoftimin për Kontratë dhe DT, në specifikacionin teknik dhe listën e çmimeve, tregon se AK-ja posedon gjashtë automjete të tipit Audi dhe Škoda. Autoriteti kontraktues kërkon pajisje diagnostikuese për ODIS, pa pasur në posedim asnjë automjet të këtij lloji.

Po ashtu, AK-ja në specifikacionin teknik dhe listën e çmimeve ka automjete të tjera si: Suzuki Grand Vitara 2.4, Suzuki SX4, Nissan Pathfinder, etj., por për këto automjete, të cilat AK-ja i ka shumicë, nuk ka kërkuar fare pajisje për diagnostikim, duke specifikuar kodin dhe emrin e pajisjes. Ndërsa për automjete të cilat posedon vetëm një kopje, ka kërkuar pajisje diagnoze origjinale.

Kërkesat Nr. 3 për pikat d, dh dhe é janë kërkesa diskriminuese dhe jo transparente. Këto kërkesa janë në kundërshtim me nenin 7, 27, dhe 28 të LPP-së. Që nga themelimi i AK-së, MSH-së, në historikun e saj për të njëjtin aktivitet të prokurimit gjithmonë është kërkuar vetëm pajisje për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve. Po ashtu, edhe në aktivitetin e fundit për këtë lloj të prokurimit, në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e tenderit, ka kërkuar:

- Pajisje për diagnostikimin e automjeteve minimum 1 copë.

Në kuptim të Nenit 7, 27 dhe 28 të LPP-së, dhe duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, Neni 17 dhe 25, përmes Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, AK-ja duhet të bëjë korrigjimin e DT-së për pikat d, dh dhe é, pasi këto pajisje nuk përkojnë me natyrën dhe objektin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse as AK-ja, asnjëherë, nuk ka kërkuar pajisje të tilla.

Bazuar në faktet e mësipërme, konsiderojmë se këto kërkesa nuk janë në harmoni me LPP-në dhe objektin e këtij tenderi. Posedimi i pajisjeve të përmendura më lart duhet të korigjohet në dosjen e tenderit, sepse ato vetëm kufizojnë konkurrencën në mënyrë të paarsyeshme.

Pretendimi 2.

Sa i përket kërkesës në Njoftimin për Kontratë, në Kapacitetin Teknik dhe Profesional, respektivisht neni 9.1 & 9.2 në DT, është kërkuar që Operatorët Ekonomikë duhet të kenë në pronësi ose në marrëveshje me qira një servis funksional për automjete, i cili ndodhet jo më larg se 5 km nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë.

Në kërkesën e AK-së, specifikohet që servisi të ndodhet jo më larg se 5 km nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo nuk është në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP). Ministria e Shëndetësisë, në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, ka përfshirë edhe departamente të tjera që janë nën Ministrinë e Shëndetësisë, si: Departamenti i Sistemit të Informacionit Shëndetësor, Departamenti Ligjor, Departamenti për Integritet Evropian dhe Kordinim të Politikave, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve, Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor, Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Pëgjithshme, Departamenti për Cilësi, Siguri, Licencim dhe Akreditim të Institucioneve Shëndetësore, Departamenti për Buxhete dhe Financa, dhe Instituti Special i Shtimes.

Nga objekti i AK-së (Ministria e Shëndetësisë), me adresë në Rr. Zagrebi, Prishtinë, deri te Instituti Special i Shtimes, është një largësi prej 30 km. Po ashtu, nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë në Rrugën Zagrebi deri te Departamenti Shëndetësor i Burgjeve është një largësi prej 3.1 km, ndërsa departamentet e tjera janë të vendosura brenda qytetit të Prishtinës.

Kërkesa me Nr. 6 është diskriminuese, pasi Ministria e Shëndetësisë në qytetin e Prishtinës dhe në territorin e Republikës së Kosovës posedon edhe departamente të tjera. Shumica e automjeteve i përkasin këtyre instituteve dhe departamenteve. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues (MSH) ka dhe disa seli të tjera me vendndodhje në qytetin e Prishtinës. Si është e mundur që AK-ja, me këto departamente që janë brenda qytetit të Prishtinës, të vendosë kriterin që servisi duhet të ndodhet në një distancë jo më të madhe se 5 km nga objekti i MSH-së, duke u referuar vetëm në një pikë të vetme?

Për këtë arsye, në kuadër të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, kërkohet korrigjimi i DT-së dhe që largësia e servisit nga lokacioni i objektit të mos jetë më shumë se 10 km nga qyteti i

Prishtinës, pasi AK-ja posedon departamente dhe seli të ndryshme brenda qytetit të Prishtinës. Kjo kërkesë është e papranueshme dhe e pabazuar, pasi AK-ja ka disa departamente në qytetin e Prishtinës, dhe vendosja e një distance 5 km është e kufizuar dhe e padrejtë për konkurrencë të barabartë. Kriteri i vendosur në DT, që servisi të ndodhet jo më larg se 5 km nga objekti i MSH-së, është i dëmshëm për mundësinë e ofertimit nga kompani të tjera që ofrojnë shërbime të mirëmbajtjes dhe servisit të automjeteve.

Në qytetin e Prishtinës, vetëm dy kompani ofrojnë shërbime të tilla, dhe ato janë të detyruara të respektojnë këtë kërkesë që e kufizon konkurrencën, duke bërë të pamundur për kompani të tjera, që janë të vendosura në rajone të tjera të Prishtinës, të marrin pjesë në aktivitetin e prokurimit.

Shënim: Asnjëherë në asnjë autoritet të Republikës së Kosovës nuk është përcaktuar një kërkesë të tillë, të natyrës së njëjtë për servisim dhe mirëmbajtje automjesh. Autoritetet tjera në Republikën e Kosovës nuk vendosin kriterin e distancës 5 km.

Prova nr. 1:

- Autoriteti Kontraktues i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka publikuar një aktivitet prokurimi me titull “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve” dhe ka kërkuar që servisi të jetë jo më larg se 15 km nga qyteti i Prishtinës. Kjo është një praktikë e zakonshme dhe nuk vendos kufizime diskriminuese si ajo që është përcaktuar nga MSH.

Prova nr. 2:

- Autoriteti Kontraktues i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka kërkuar që servisi të jetë jo më larg se 10 km nga qyteti i Prishtinës.

Prova nr. 3:

- Ministria e Punëve të Jashtme ka publikuar një aktivitet prokurimi që kërkon që servisi të jetë jo më larg se 15 km nga objekti i Ministrisë.

Prova 04.3:

- Autoriteti Kontraktues i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka vendosur një kufizim të largësisë prej 15 km për servisin.

Përfundim:

Siç mund të shihet, asnjë autoritet tjetër i Kosovës nuk ka vendosur kriterin e distancës prej 5 km nga objekti për servisin. Për këtë arsye, kërkohet ndryshimi i këtij kriteri në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e një grupi më të gjerë operatorësh ekonomikë dhe të sigurohet konkurrencë e drejtë dhe e barabartë. Në përputhje me LPP-në dhe rregullat e proceseve të prokurimit, kjo kërkesë është diskriminuese dhe duhet të korrigjohet.

Lidhur me pretendimet e OE Gani Krasniqi B.I.eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0673 ka vlerësuar si në vijim:

OE ankues ka parashtuar ankesë në OSHP si palë e pakënaqur me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit nga ana e AK-së, duke ngritur disa pretendime të cilat janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendim

OE ankues pretenon që: *“Sa i përket kërkesës në Njoftimin për kontratë, te Kapaciteti teknik dhe profesional, respektivisht neni 9.1 & 9.2, në DT, është kërkuar te Kërkesa me Nr 6. Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose në marrëveshje me qira një servis funksional për automjete, i cili ndodhet jo më larg se 10 km nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë. Nuk është në përputhje te plot me LPP-në. AK-ja MSH-ja në kuader të këti aktiviteti te prokurimit me titull: “Servisimi i automjeteve te MSH-se” ka përfshirë edhe Departamente tjera te cilate janë në kuader te Ministris së Shëndetsisë. Ku ka prej tyre që janë në largësi dei në 30 km, ndërsa AK thirret vetëm në një pikë referuese.”*

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin e ngritur sqaron që AK në kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ka vendosur kriterin sa i përket servisit të automjeteve që i njëjti të mos ndodhet më larg se 10 km nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë, OE ankues e sheh këtë kriter si kufizues për faktin se siç sqaron ka edhe departamente të tjera të cilat ndodhen në largësi shumë më të madhe se sa kilometrat e kërkuara. Sa i përket këtij pretendimi të ngritur eksperti pasqyron që është i vërtetë fakti që jo të gjitha departamentet e Ministrisë ndodhen në të njëjtin lokacion, mirëpo përderisa të gjitha departamentet e përfshira janë pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë, të njëjtit kanë të drejtë të përdorin objektin kryesor si një pikë referuese duke marrë parasysh faktin që shumica prej departamenteve janë të pozicionuara në qytetin e Prishtinës. Tutje sqarojmë që sipas Aneksi 1 të dosjes së tenderit, tek pjesa e përshtimit të shërbimeve sqarohet qartë që është Autoriteti Kontraktues ai që është përgjegjës për transportimin e automjeteve nga lokalet e tyre deri tek lokali i operatorit ekonomik dhe anasjelltas, kështu që sa i përket çështjes së departamenteve të tjera të cilat ndodhen në një largësi më të madhe sqarohet që është kompetencë e vet autoritetit mënyra e organizimit të transportimit të tyre deri tek lokali i operatorit ekonomik për servisimin e rregullt të automjeteve, kështu që konsiderojmë që nuk ka nevojë që të shihet si problem ky aspekt.

Në anën tjetër, duke marrë parasysh faktin se shumë servise të veturave për shkak të natyrës së tyre të punës dhe të cilat duhet t'i plotësojnë edhe kriteret e tjera të vendosura në dosjen e tenderit ku kërkohet që të jenë servise më të mëdha, ndodhen jashtë qytetit të Prishtinës, mendimi i ekspertit shqyrtues është që në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrje më e madhe e operatorëve të interesuar ashtu siç e parasheh edhe neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik, ky kriter do të duhet të ndryshohet në atë që servisi funksional për automjete të mos ndodhet më larg se 15 km nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë. Distanca më e largët konsiderojmë që vështirëson mbarëvajtjen e aktiviteteve të Ministrisë, për arsye se bëhet problematike edhe vet transportimi i automjeteve dhe koha për transportin e tyre në lokacione më të largëta. Nga ajo çfarë sqaruam më lartë vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është pjesërisht i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për

Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas pretendimit ankimor të paraqitura në ri-ankes sipas numrit rendor 1 ku eksperti në raportin e tij nuk e ka trajtuar , për Paisjen diagnoz originale BMW ISTA+. Paneli Shqyrtues ka vërejtur që ky pretendim ankimor fillimisht është aprovuar sipas kërkesë për rishqyrtim të OE ankues nga ana e AK , vendimi mbi kërkesën për Rishqyrtim i datës: 17.07.2025 duke citoj ‘ ‘ *Pranohet Pretendimi juaj ankimor nr. 1 Korrigjohet kërkesa nr. 3 e DT, te Kapaciteti mbi mundësitë teknik dhe profesional 9.1 & 9.2, Ne vend te kërkesave: d. Pajisje për diagnostikimin e automjeteve për Mercedes benz C4 plus original dh. Diagnoza BMW ISTA+, Kerkohet nje pajisje me pershkrimin: Pajisje speciale kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve.*’ ’ , kështu duke publikuar edhe B54 Formularin për korrigjimin e procedurës, mirpo pas pranimit të ankesës pranë OSHP-se nga ankuesi te dates : 21.07.2025 AK-ja sipas kërkesës për Rishqyrtim pranë AK-së dates 18.07.2025 nga OE Bastri. Ademi BI ‘ ‘NTSH EUROPA’ ’, kështu duke kërkuar ti vendoset kjo pajisje AK -ja edhe pse vet e ka larguar këtë kërkesë sipas vendimit të tyre te dates: 17.07.2025 , Ndërsa në vendimin të AK-se (lidhur me kërkesën për rishqyrtim nga OE Bastri. Ademi BI ‘ ‘NTSH EUROPA’ ’ sipas vendimit të AK-së dates 21.07.2025 prap e ka vendosur këtë kërkesë kështu duke mos pasur mundësinë që OE ku fillimisht ka parashtruar ankese pran OSHP-se të paraqet si pretendim ankimor , mirpo këtë e ka vendos në ri-dërgim të ankesë, veprime të thilla nga AK-ja në raste të tilla ku fillimisht e largojnë e pas disa dite prap e vazhdojnë janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 7 të LPP-së kështu duke krijuar konfuzitet tek OE-te që shprehin interesim për të ofertuar në këtë procedur. Andaj nisur nga rethanat e krijuara nga vet AK -ja Paneli Shqyrtues e mbështet këtë pretendim ankimor, ngase vet emërtimi Paisje speciale kompjuterike për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve nënkupton se është paisje e cila kryen funksionin e njëjtë pa pasur nevojë të përcaktohen emërtimet ,dhe është paisje e cila kryen të gjitha shërbimet për të gjitha llojet/tipet e automjeteve , për këtë paisje kemi edhe konsistencë të vendimeve të OSHP-se.

Lidhur me pretendimin nr 2 Paneli Shqyrtues mbështet këtë pretendim ankimor dhe konstaton se AK-ja nuk mund të thirret në këtë rastë nga një pikë referuese sipas selisë së përcaktuar me km prej 10, përderisa AK-ja ka edhe objekte-seli të tjera nën menaxhim e të cilat gjinden në Prishtinë dhe nëkohësisht edhe në qytet tjera , sikurse edhe eksperti shqyrtues në raportin e saj sqaron se ky kriter duhet të ndryshohet në atë që servisi funksional për automjete të mos ndodhet më së largu 15 km , nga objekti i Ministrisë së Shëndetësisë .

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve të MSH-se” me numër të prokurimit:206-25-4944-2-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve

ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik Gani Krasniqi B.I. aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi i automjeteve te MSH-se” me numër të prokurimit: 206-25-4944-2-2-1qe AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III dhe IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Gani B. Krasniqi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: